



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO OBRAZOVANJE, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Numër: 97/24

Datë: 16.12.2024

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, neni 35 dhe 36 të Statutit, Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024 për Procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të Punës nr. 03/L212, Vendimin me nr. prot. 67/24 të datës 13.11.2024, për procedurën e rekrutimit sipas konkursit nga: IPK të datës:14.11.2024, për pozitën e punës **Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi** (një vend pune), Këshilli Shkencor i IPK-së, më datë 11.12.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për përzgjedhjen e z. Murteza Osdautaj në pozitën e punës **Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi**, sipas konkursit të shpallur më datë: 14.11.2024 dhe Raportit të Komisionit Vlerësues/Recensues, të datës 11.12.2024.

A R S Y E T I M

Në konkursin publik të shpallur nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, të datës 14.11.2024, në listën definitive është paraqitur vetëm (1) një kandidat:

1. Dr.sc. Murteza Osdautaj

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, vendimin me nr. prot. 67/24, të datës 13.11.2024, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publikë, Komisioni Vlerësues/Recensues, përgjegjës për procedurën e rekrutimit sipas konkursit të shpallur nga IPK, të datës 14.11.2024, ka konstatuar se kandidati Dr.sc. Murteza Osdautaj, i ka plotësuar kriteret profesionale e shkencore për zgjedhjen në pozitën **Bashkëpunëtor shkencor**

për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi, ashtu siç është paraqitur në dispozitiv të këtij vendimi dhe me Raportin Vlerësues/Recensues i ka propozuar Këshillit Shkencor për përzgjedhjen e kandidatit të lartpërmendur.

Këshilli Shkencor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 11.12.2024, ka analizuar Raportin e Komisionit Vlerësues/Recensues dhe, pa asnjë vërejtje, ka votuar dhe miratuar për përzgjedhjen e komisionit vlerësues dhe nxjerrjen e këtij vendimi, ashtu si ka vlerësuar komisioni.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit të Raportit të Komisionit Vlerësues/Recensues, në faqen zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Kryesues i Këshillit Shkencor

Dr.sc. Osman Buleshkaj

